POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Tipike shqiptare! Mamaja i 'tërheq veshin' Rita Orës për postimin e fundit në Instagram
2 Kronologjia e pengmarrjes së Nertil Buzit në Londër 4 vite më parë, grupi i vlonjatëve i hoqën thonjtë me pinca! Pse prokuroria u tërhoq nga akuzat
3 Oriola Marashi reagon ashpër pas përplasjes mes Efit dhe Kiarës: Ai ka sy vetëm për dashurinë e vet
4 Dorë për dore me Donaldin, Bora Zemani na zbulon prapaskenat e 'Dancing With the Stars'
5 Një rrjet miliardash nga Amerika në Ballkan dhe një mungesë që bie në sy: Kosova

Kronikë

# Shpallet në kërkim autori i plagosjes së 22-vjeçarit në Kurbin, nën kërcënimin e armës i mori edhe mjetin (EMRI)

*Policia ka zbardhur ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e 25 korrikut në Kurbin, ku mbeti i plagosur me armë zjarri një 22-vjeçar. Si autor i dyshuar është shpallur në kërkim Klodjan Ndoj, 47 vjeç, banues në Sanxhak.*



*Foto nga fshati Gjorm ku u regjistruan të shtënat*

Redaksia
26 Korrik, 13:34 | **Përditesimi: 26 Korrik, 13:41**

Share Post

**KURBIN** – Policia ka zbardhur ngjarjen e ndodhur mbrëmjen e 25 korrikut në Kurbin, ku ***mbeti i plagosur me armë zjarri*** një 22-vjeçar. Si autor i dyshuar është shpallur në kërkim Klodjan Ndoj, 47 vjeç, banues në Sanxhak.

Sipas hetimeve, 47-vjeçari dyshohet se e ka qëlluar 22-vjeçarin Veron Pasha me armë zjarri në këmbë dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Pas plagosjes, autori është larguar nga vendi i ngjarjes duke i marrë të riut edhe automjetin, nën kërcënimin e armës.

LEXO EDHE:
**Fishta, fshati që po ndërton të ardhmen përmes turizmit! Vizitorët: Përvojë e veçantë, mikpritje, natyrë dhe ushqim i shijshëm**

Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes janë sekuestruar dy gëzhoja, ndërsa hetuesit po punojnë për gjetjen e autorit.

> *"Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore të kryera nga grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, për ngjarjen e ndodhur më datë 25.07.2026, bazuar në provat e siguruara, specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda në DVP Lezhë, në bashkëpunim me specialistët e Komisariatit të Policisë Kurbin, identifikuan dhe shpallën në kërkim shtetasin K. N., 47 vjeç, banues në Sanxhak, Kurbin, i dyshuar si autor i plagosjes me armë zjarri të shtetasit V. P., 22 vjeç, banues në Sanxhak, Kurbin, i cili ndodhet jashtë rrezikut për jetën.*
>
> *Nga veprimet hetimore rezultoi se autori, pas plagosjes, është larguar nga vendi i ngjarjes, duke i marrë 22-vjeçarit, nën kërcënimin e armës, automjetin. Gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, 2 gëzhoja. Punohet intensivisht për kapjen e autorit dhe gjetjen e automjetit të 22-vjeçarit", njofton policia.*

Materialet i janë referuar Prokurorisë për veprat penale "Plagosja e rëndë me dashje", "Vjedhja me armë" dhe "Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe municionit".

-------------------------------

**Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë**

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Veron Pasha | Klodjan Ndoj | Lezhe | Kurbin | te shtena me arme

Komento

## Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 24 Korrik, 13:38

**Epoka e re e kërkesave, mendoni se reagimi i Ramës për protestat është i duhuri?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Qëlloi me armë për të kanosur 6 persona, arrestohet 38-vjeçari në Dibër! 9 të tjerë nën hetim
26 Korrik, 12:39

Kurbin/ 22-vjeçari plagoset me armë zjarri, dërgohet në spital nga i vëllai! S'dihen rrethanat, policia në kërkim të autorit (EMRI)
25 Korrik, 19:50

Shiste bizhuteri floriri dhe ora dore të vjedhura, arrestohet argjendari në Lezhë! Sekuestrohen sendet e çmuara, vlera arrin në 300 mijë euro (EMRI+VIDEO)
24 Korrik, 15:39

Lezhë/ Një person goditet me tytën e pistoletës, transportohet në spital (VIDEO)
23 Korrik, 22:35

Lezhë/ Djegia e transformatorit, rikthehet energjia elektrike pas 12 orësh në lagjen 'Besëlidhja'
23 Korrik, 10:09

3 vite burg për thirrjet kundër pllakës së Erdoğanit në Laç, 42-vjeçari dënohet në mungesë për nxitje urrejtjeje
Elvis Hila
23 Korrik, 09:03

Lezha nën ritmet e 'Country fest', artistët e vegjël shfaqje në qendër të qytetit (VIDEO)
Elvis Hila
22 Korrik, 15:12

Aksident në afërsi të lapidarit në Lezhë-Shëngjin, 'Audi' përfundon mes gardhit metalik! Shkak dyshohet shpejtësia e lartë, plagoset 31-vjeçari
22 Korrik, 10:09

Kryebashkiaku Pjerin Ndreu: Protestat ndikuan në turizëm, por Shëngjini mbetet destinacion i frekuentuar
21 Korrik, 21:38

Mirditë/ Zjarr në fshatin Shpërdhaz, dyshohet i qëllimshëm
21 Korrik, 17:44

Lezha nis ndërhyrjet kundër përmbytjeve, 84 milionë lekë investim për pritat malore, përrenjtë dhe urat (VIDEO)
Elvis Hila
21 Korrik, 12:02

Momente paniku në Ranën e Hedhun, nënë e bir rrezikojnë mbytjen! Ndërhyrja e shpejtë shmang tragjedinë në plazhin e Shëngjinit
20 Korrik, 15:12

Lajmi i fundit
Përplasi turmën me furgon, qëllohet për vdekje gjatë operacionit policor autori i sulmit në Berlin
26 Korrik, 19:28

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit



Përplasi turmën me furgon, qëllohet për vdekje gjatë operacionit policor autori i sulmit në Berlin

26 Korrik, 19:28

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com